



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI STATISTIKOR

JANAR - PRILL 2023

Tabela e Lëndës

1	Treguesit kryesorë të veprimitarisë audituese
2	Konkluzionet në Auditimet e TI
3	Mesazhet në Auditimet e Performancës
4	Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
5	Zhvillimi dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
6	Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
7	Auditime në media
8	Anekse

AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE



1. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

1.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – prill 2023, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 234 datë 16.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, duke kryer dhe evaduar 16 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periodha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



1.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar – prill 2023, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 55 subjekte duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara në numër



1.3 Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – prill 2023, ka përfunduar kryerjen e 16 auditimeve, duke dhënë:

- 15 opinione për 12 auditime, nga të cilat: 3 opinione financiare, 6 opinione përputhshmërie dhe 6 opinione për 3 auditimet e kombinuara;
- 3 mesazhe auditimi për 3 auditime performance;
- 1 konkluzion për 1 auditim tematik IT.

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



18


Tabela nr.1: Opinonet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Te tjera		Grand Total
	pamodifikuar	modifikuar	mesazh	konkluzion	
Financiar	1	2			3
I kombinuar	3	3			6
IT				1	1
Performance			3		3
Përputhshmërie	3	3			6
Grand Total	7	8	3	1	19


Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit, në bazë të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinionit i dhënë mund të jetë "i modifikuar" ose "i pamodifikuar".

- Opinonet e pamodifikuar mund të jenë:
 - të pakualifikuar
 - të pakualifikuar me theksim të çështjes
- Opinonet e modifikuar mund të jenë:
 - të kualifikuar
 - të kundërt
 - refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinioneve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



1.4 Rekomandimet sipas natyrës



1.4.1 Përmirësime ligjore & Masa organizative

Gjatë periudhës janar – prill 2023, për 16 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 280 masa organizative dhe 5 përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:


Tabela nr.2: Përmirësime ligjore dhe masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime ligjore
Institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore dhe të varësisë	4	54	2
Institucione të administrimit të asetëve dhe mbrojtjes së mjedisit	1	29	-
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	5	80	-
Shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj	2	53	-
Institucione në të cilat janë kryer auditimet e performancës	3	49	3
Institucione në të cilat janë kryer auditimet e TI	1	15	0
Total	16	280	5

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë në:

- (i) *fushën e drejtësisë* për çështje që lidhen me: kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve; dhe me ndihmën juridike të ofruar nga shteti mbi ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave për të paraburgosurit; si dhe
- (ii) në *fushën e mbrojtjes së sipërmarrjes* për rishikimin dhe ridimensionimin e rolit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në drejtim forcimit të promovimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave shtetërore në mbështetje të start-upeve dhe ekosistemit të tyre.


Infografik nr. 5: Rekomandimet për përmirësime ligjore



1.4.2 Gjetje me efekte financiare negative në buxhetin e shtetit

Gjatë periudhës janar-prill 2023, janë dhënë 60 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 2,311,028 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 87,583 mijë lekë, dhe menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 2,223,445 mijë lekë.

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare ne buxhet sipas fushave kryesore (ne '000 lekë)



Rreth 2% e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar në fushën e të ardhurave; ndërsa pjesa më përfaqësuese, rreth 98% është konstatuar në fushën e shpenzimeve ku:

- vlera prej 47,987 mijë lekë e konstatuar në subjektin Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A për shkak të mos parashikimit nga palët, në kontratën e qirasë të detyrimit për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri; dhe
- vlera prej 38,051 mijë lekë e konstatuar përgjatë zbatimit të punimeve (si psh diferenca në volumin e punimeve, zëra të paverifikueshëm punimesh, etj) në 5 subjekte.

Sa i takon menaxhimit jo efektiv të fondeve**, në shumën totale prej 2,223,445 mijë lekë, rreth 66% e vlerës është konstatuar në fushën e të ardhurave, ndërsa rreth 34% në fushën e shpenzimeve, ku:

- rreth 99% e vlerës në fushën e shpenzimeve, përbëhet nga shkeljet në "procedurat e prokurimit" dhe "zbatimin e punimeve"; ndërsa
- rreth 90% e vlerës në fushën e të ardhurave përbëhet nga të ardhurat e munguara që administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si pasojë e krijimit të debitorëve për moslikuidime të tarifave dhe taksave vendore (më së shumti në Bashkitë: Kamëz (631,061 mijë lekë), Belsh (108,398 mijë lekë), Lezhë (402,195 mijë lekë) dhe Vau i Dejës (195,912 mijë lekë).

*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4, Tabela 4.3 dhe 4.4

**Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4, Tabela 4.3 dhe 4.5

KLSH, në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë periudhës janar – prill 2023, ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik, në të ardhura dhe shpenzime në shumën totale prej 87,583 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërbllim dëmi të njëjtën shumë.

Tabela në vijim paraqet vlerën e demit ekonomik dhe atë të menaxhimit jo efektiv të fondeve, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela nr 3: Efektet financiare negative sipas fushave (ne '000 lekë)

Efekte negative financiare	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Total
Shpenzime	86,038	742,121	828,159
Procedura prokurimi	1,220	537,049	538,269
Shpenzime per paga & sig. shoq	-	1,972	1,972
Shpenzime të tjera	47,987	-	47,987
Zbatim punimesh	36,831	203,100	239,931
Të ardhura	1,545	1,481,324	1,482,869
Të ardhura në urbanistikë	-	496	496
Të ardhura nga qirratë/PPP/shitje	1,545	107,159	108,704
Të ardhura nga tatim-taksat*	-	1,337,569	1,337,569
Të ardhura të tjera	-	36,100	36,100
Total	87,583	2,223,445	2,311,028


* administruar nga njësitë e vetëqeverisje vendore

1.5 Masa disiplinore dhe administrative

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 83 rekomandime për masa disiplinore.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 61 masave disiplinore (pasi për 22 masa të tjera, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna):

Infografik nr. 7: Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës



UJËSJELLËS - KANALIZIME SH.A TIRANË (UK SHA)



Ka munguar strategjia, politikat dhe aktet rregullative që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në shoqërinë UK sha, Tiranë. Gjithashtu, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit, janë të pamjaftueshëm për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Edhe pse nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin, është e lartë.

3. MESAZHET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS

FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS NË VENDIN TONË




Vendosja e parimit të barazisë gjinore si një parim thelbësor i ciklit buxhetor, është e vetmja rrugë e duhur për të rrënjësuar kulturën e barazisë gjinore në vendin tonë. Për këtë qëllim, institucionet duhet të angazhohen maksimalisht në drejtim të:

- rritjes së impaktit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor;
- promovimit dhe vendosjes së treguesve të matshëm sasior e cilësor gjinor në buxhetet e institucioneve;
- koordinimit midis institucioneve për zbatimin e strategjive të barazisë gjinore dhe integrimin e tyre me strategjitë sektoriale;
- monitorimit të saktë të këtyre politikave për të konkretizuar angazhimin e grave në të gjitha fushat e ekonomisë së vendit tonë që sigurojnë fuqizimin e tyre.



PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PARABURGIMIT

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet të luajnë një rol proaktiv në garantimin e të drejtave të shtetasve të paraburgosur, nëpërmjet krijimit të një qasje të re, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre, vetë respektit dhe dinjitetit njerëzor. Sistemi penitenciar ka nevojë edhe për një bashkëveprim më dinamik ndërmjet institucioneve shtetërore përgjegjëse, veçanërisht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.



TË ARDHURA NGA TAKSAT DHE TARIFAT E BASHKIVE PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË

Bashkitë kanë një autonomi financiare jo të mirë për shkak se pjesa më e madhe e fondeve ju vijnë nga transfertat e pa kushtëzuara dhe të kushtëzuara, ndërkohë që fondet nga të ardhurat e veta janë të pa mjaftueshme për funksionimin e tyre.

Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2020 për menaxhimin e pandemisë, krahasuar me totalin e shpenzimeve, rezultuan të jenë në masën 2%.

- Bashkitë nuk kanë hartuar një plan për rimëkëmbjen sa i përket pasojave të pandemisë Covid-2019.
- Procesi i rimëkëmbjes nuk identifikohet përmes një fondi të veçantë por vijon të mbetet një koncept abstrakt për emergjencat civile të bashkive.
- Situata e krijuar nga pandemia është menaxhuar nga pushteti qendror, bashkitë thjeshtë kanë vepruar në përshtatje me rregullat e miratuara, duke mos u angazhuar për miratimin e rregullave të tjera për ofrimin e shërbimeve operacionale, specifike për karakteristikat e secilës bashki.

4. NIVELI I PRANUESHMERISË SË REKOMANDIMEVE*


Gjatë 4 mujorit të vitit 2023, Kontrolli i i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 345** masa nga të cilat 280 janë masa organizative, 5 janë masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, 22 masa shpërblim dëmi dhe 38 masa 3-E efekte negative për shkak të parregullsive.

Nga 345 masa në total janë pranuar 342 masa ose rreth 99% e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar 3 masa ose 1% e masave të rekomanduara.

Konkretisht:

- nga 280 masa organizative, janë pranuar 277 masa ose 99% e masave të rekomanduara;
- nga 5 masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore janë pranuar 5 masa ose 100% e masave të rekomandura;
- nga 22 masa shpërblim dëmi janë pranuar 22 masa ose 100% e masave të rekomandura; dhe
- nga 38 masa 3-E, efekte negative për shkak të parregullsive janë pranuar 38 masa ose 100% e masave të rekomanduara.

Infografik nr. 8: Pranueshmëria e masave sipas llojit



* Pa përfshirë masat disiplinore dhe administrative pasi statusi i tyre do të shikohet përgjatë zbatimit të rekomandimeve

** Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar".

5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

5.1 Struktura dhe Organika


Gjatë vitit 2023, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në një linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore.

Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 209 punonjës nga të cilët: stafi auditues 163 punonjës (ose 78% të numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 18 kryeauditues
- 33 auditues të lartë
- 75 auditues të parë
- 37 auditues të dytë

Gjatë vitit 2022 në KLSH janë rekrutuar 38 punonjës të rinj dhe janë larguar 19 punonjës.

Infografik nr. 9: Organizimi i Burimeve Njerëzore



5.2 Trajnimet

Gjatë periudhës janar-prill 2023, u realizuan 31 tema trajnimesh, nga të cilat 14 nga ASPA dhe 17 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAL, IDI, SAI i Suedisë dhe ai i Norvegjisë. U trajnuan gjithsej 127 auditues, duke realizuar në total 529 ditë-njerëz trajnime, ose realizuar mesatarisht rreth 4.2 ditë trajnimi/auditues.


Këtë vit, ndryshe nga periudha që lam pas, u rikthyen trajnimet në sallë, në shërbim kjo të rritjes së ndërveprimit mes pjesëmarrësve, ku nga 283 ditë-njerëz trajnime të organizuara nga KLSH, vetëm 14 (ose 5%) janë realizuar on line.



Ndër temat kryesore të trajtuara gjatë këtij 3 mujori, nga SAI-e partnere dhe/ose komuniteti EUROSAL përmendim:

- “Qasja praktike DEA SG2”, organizuar nga EUROSAL;
- “IDI-SPMR Round 2, implementimi dhe raportimi”, organizuar nga IDI;
- “Ndikimi i transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, organizuar nga SAI i Norvegjisë;
- “Konceptet e auditimit të performances”, organizuar nga SAI i Suedisë.

Infografiku nr. 10: Ditët e trajnimeve sipas organizatoreve



Temat kryesore të trajtuara gjatë këtij 4 mujori, me burime të brendshme të KLSH-së, kishin në fokus çështje që lidhen me:

- kuadrin metodologjik mbi të cilin mbështetet aktiviteti auditues, përfshirë parimet dhe standardet INTOSAL si dhe praktika të tjera të mira;
- manualët e auditimit;
- shembuj konkret auditimesh të suksesshme;
- kontrollin e cilësisë që ndiqet gjatë procesit auditues; etj.


6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Kontrulli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës janar - prill 2023, ka administruar 117 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave apo denoncimeve.

Ndërkohë, 7 ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Kontrulli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar - prill 2023, ka trajtuar 10 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë, deputetë dhe përfaqësues të medias, nga të cilat 1 prej tyre vlerësuar jashtë fushës së kompetencës së KLSH-së. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH.

Infografik nr. 11: Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH, janar-prill 2023



7. AUDITIME NË MEDIA



Konstatimet e KLSH-së, reflektuar në raportet e auditimit, vazhdimisht bëjnë jehonë në media për nga ndjeshmëria publike e çështjes së trajtuar.

Përgjatë 4 muajve të parë të vitit 2023, në shtypin e shkruar janë publikuar 125 artikuj që i referohen rezultateve nga auditime të ndryshme të KLSH-së; ndërsa në mediat audio-vizive dhe online, janë publikuar 528 artikuj dhe kronika televizive.

Gjatë periudhës janar-prill 2023, pati pasqyrim të veçantë në media (me rreth 40 artikuj), auditimi i kryer në *Qendrën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Vlorë* dhe problematikat që ai trajtoi lidhur me trajtimin e rezidentëve që marrin shërbim në këtë qendër, si edhe alokimin e fondeve në drejtim të përmbushjes së nevojave dhe krijimin e kushteve optimale për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar.

8. ANEKSE

ANEKS 1: Auditimet sipas llojit

Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr. auditimesh	Pesha në %
Financiar	3	19%
I kombinuar	3	19%
Performance	3	19%
Perputhshmerie	6	38%
IT	1	6%
Total	16	100%

Tabela 1.1: Misionet e auditimit në numër, sipas departamentit

Departamenti i Auditimit	Nr. auditimesh	Temë auditimi	Grand Total
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja	2		2
Departamenti i Auditimit IT	1		1
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	4		4
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	6	1	7
Departamenti i Auditimit të Performancës		2	2
Total	13	3	16

Tabela 1.3: Auditimet sipas cdo departamenti

Nr. rendor	Nr. kumulativ	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
1	1	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë
2	2	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
3	3	Gjykata e Lartë
4	4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore		
5	1	Bashkia Belsh
6	2	Bashkia Vau I Dejës
7	3	Bashkia Lezhë
8	4	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë
9	5	Bashkia Kamëz
10	6	Auditim Performance: "Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë"
11	7	Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja		
12	1	Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A
13	2	Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A
Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit		
14	1	Auditim IT: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A
Departamenti i Auditimit të Performancës		
15	2	Auditim Performance me temë: Performanca e Shërbimit të Paraburgimit
16	3	Auditim Performance me temë: Fuqizimi Ekonomik i gruas në vendin tonë

ANKES 2: Opinionet /Mesazhet/Konkluzionet e auditimit

Tabela 2: Opinioni/mesazhi/konkluzioni sipas llojit te auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Te tjera		Grand Total
	pamodifikuar	modifikuar	mesazh	konkluzion	
Financiar	1	2			3
I kombinuar	3	3			6
IT				1	1
Performance			3		3
Përputhshmërie	3	3			6
Total	7	8	3	1	19

Tabela 2.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit te auditimit për çdo subjekt/temë

Lloji i auditimit	OPINIONET E AUDITIMIT			TË TJERA		Grand Total
	Me theksim te çështjes	I pamodifikuar	I modifikuar	Me konkluzion	Me mesazh	
Financiar	1		2			3
Bashkia Belsh	1					1
Bashkia Lezhe			1			1
Bashkia Vau Dejës			1			1
I kombinuar	1	2	3			6
Bashkia Kamëz	1 ¹		1 ²			2
DPOP tiranë			2 ³			2
Gjykata e Lartë		2				2
Performance					3	3
Fuqizimi ekonomik i gruas ne vendin tone					1	1
Performanca e Shërbimit të Paraburgimit					1	1
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë					1	1

¹ Per pasqyrat financiare

² Opinion i kualifikuar për auditimin e përputhshmërisë

³ Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë

Lloji i auditimit	OPINIONET E AUDITIMIT			TË TJERA		Grand Total
	Me theksim te çështjes	I pamodifikuar	I modifikuar	Me konkluzion	Me mesazh	
Përputhshmërie		3	3			6
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug			1			1
AKSHI			1			1
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes		1				1
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë		1				1
Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.			1			1
Ujësjetllës-Kanalizime Tirane SHA		1				1
IT				1		1
Ujësjetllës Kanalizime Tirane Sh.A				1		1
Total	2	5	8	1	3	19

ANEKS 3: Masa organizative & Përmirësime Ligjore

Tabela 3: Masa organizative & Përmirësime Ligjore sipas llojit të institucioneve

Llojet e auditimit	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime Ligjore
Financiar & Përputhshmërie	12	216	2
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	5	80	0
Institucione te pavarura & te qeverisjes qendrore	4	54	2
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	1	29	0
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	2	53	0
IT	1	15	0
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	1	15	0
Performance	3	49	3
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	3	49	3
Total	16	280	5

Tabela 3.1 : Masa organizative & Përmirësime Ligjore sipas subjekteve të audituara

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime Ligjore
Institucione te pavarura	1	8	0
1. Gjykata e Lartë	1	8	0
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	3	46	2
2. AKSHI	1	24	0
3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	1	13	2
4. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë	1	9	0
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	1	29	0
5. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug	1	29	0
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	5	80	0
6. Bashkia Belsh	1	8	0
7. Bashkia Kamëz	1	16	
8. Bashkia Lezhë	1	11	0
9. Bashkia Vau Dejës	1	17	0
10. DPOP tiranë	1	28	0
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	3	49	3
11. Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tone	1	14	0
12. Performanca e Shërbimit të Paraburgimit	1	17	3
13. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë	1	18	0

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime Ligjore
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	1	15	0
1. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sha (TI)	1	15	0
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	2	53	0
2. Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.	1	10	
3. Ujësjetllës-Kanalizime Tirane SHA	1	43	0
Total	16	280	5

ANEKS 4: Efektet financiare negative ne buxhet

Tabela 4: Vlera e efekteve financiare negative , në '000 lekë

Efekte financiare	Dëm ekonomik		Menaxhim jo efektiv fondesh		Grand Total
	Vlera (në lekë)	Rekomandime (në nr.)	Vlera (në lekë)	Rekomandime (në nr.)	
Shpenzime	86,038	21	742,121	14	828,159
Te ardhura	1,545	1	1,481,324	24	1,482,869
Total	87,583	22	2,223,445	38	2,311,028

Tabela 4.1: Vlera e efekteve financiare negative të grupuara sipas ndikimit në të ardhura dhe shpenzime, dhe subjektit ku është konstatuar efekti, në '000 lekë

Subjektet/temat e auditimit	Dem ekonomik	Rekomandime (në nr.)	Menaxhim joefektiv fondesh	Rekomandime (në nr.)	Total	Rekomandime (në nr.)
Shpenzime	86,038	21	742,121	14	828,159	35
1. AKSHI	18,442	3	161,516	4	179,958	7
2. Bashkia Kamëz	2,168	7	526,921	1	529,089	8
3. Bashkia Vau Dejës			1,972	2	1,972	2
4. DPOP tiranë	232	1	-	-	232	1
5. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë	-	-	15,508	1	15,508	1
6. Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.	791	3	30,790	4	31,581	7
7. Ujësjetllës-Kanalizime Tirane SHA	64,405	7	5,414	2	69,819	9
Te ardhura	1,545	1	1,481,324	24	1,482,869	25
8. Bashkia Belsh	-	-	115,798	3	115,798	3
9. Bashkia Kamëz	-	-	631,061	6	631,061	6
10. Bashkia Lezhë	-	-	410,215	8	410,215	8
11. Bashkia Vau Dejës	-	-	222,134	5	222,134	5
12. DPOP tiranë	-	-	102,116	2	102,116	2
13. Ujësjetllës-Kanalizime Tirane SHA	1,545	1			1,545	1
Total	87,583	22	2,223,445	38	2,311,028	60

Tabela 4.2: Vlera e efekteve financiare negative të grupuara sipas fushave kryesore, në '000 lekë

Efektet negative financiare	Dem ekonomik	Menaxhim jo efektiv fondesh	Grand Total
Shpenzime	86,038	742,121	828,159
Procedura prokurimi	1,220	537,049	538,269
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	-	1,972	1,972
Shpenzime te tjera	47,987		47,987
Zbatim punimesh	36,831	203,100	239,931
Te ardhura	1,545	1,481,324	1,482,869

Efektet negative financiare	Dem ekonomik	Menaxhim jo efektiv fondesh	Grand Total
Te Ardhura ne Urbanistike	-	496	496
Te Ardhura nga qiratë/ shitje/blerje/koncesione/PPP	1,545	107,159	108,704
Te Ardhura nga Tatim-taksat	-	1,337,569	1,337,569
Te Ardhura te tjera	-	36,100	36,100
Total	87,583	2,223,445	2,311,028

Tabela 4.3: Vlera e efekteve financiare negative të grupuara sipas fushave kryesore, dhe subjektit ku është konstatuar efekti, në '000 lekë

Fushat ku është konstatuar efekti financiar negativ	Dem ekonomik	Menaxhim jo efektiv fondesh	Grand Total
Shpenzime	86,038	742,121	828,159
Procedura prokurimi	1,220	537,049	538,269
AKSHI	-	5,205	5,205
Bashkia Kamëz	259	526,921	527,180
Ujësjetës Kanalizime Durrës sh.a.		3,181	3,181
Ujësjetës-Kanalizime Tirane SHA	961	1,742	2,703
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	-	1,972	1,972
Bashkia Vau Dejës	-	1,972	1,972
Shpenzime te tjera	47,987	-	47,987
Ujësjetës-Kanalizime Tirane SHA	47,987	-	47,987
Zbatim punimesh	36,831	203,100	239,931
AKSHI	18,442	156,311	174,753
Bashkia Kamëz	1,909	-	1,909
DPOP tiranë	232	-	232
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë	-	15,508	15,508
Ujësjetës Kanalizime Durrës sh.a.	791	27,609	28,400
Ujësjetës-Kanalizime Tirane SHA	15,457	3,672	19,130
Te ardhura	1,545	1,481,324	1,482,869
Te Ardhura ne Urbanistike	-	496	496
Bashkia Vau Dejës	-	496	496
Te Ardhura nga qiratë/ shitje/blerje/koncesione/PPP	1,545	107,159	108,704
Bashkia Lezhë	-	817	817
Bashkia Vau Dejës	-	4,226	4,226
DPOP tiranë	-	102,116	102,116
Ujësjetës-Kanalizime Tirane SHA	1,545	-	1,545
Te Ardhura nga Tatim-taksat	-	1,337,569	1,337,569
Bashkia Belsh	-	108,398	108,398
Bashkia Kamëz	-	631,061	631,061
Bashkia Lezhë	-	402,198	402,198
Bashkia Vau Dejës	-	195,912	195,912

Fushat ku është konstatuar efekti financiar negativ	Dem ekonomik	Menaxhim jo efektiv fondesh	Grand Total
Te Ardhura te tjera	-	36,100	36,100
Bashkia Belsh	-	7,400	7,400
Bashkia Lezhë	-	7,200	7,200
Bashkia Vau Dejës	-	21,500	21,500
Total	87,583	2,223,445	2,311,028

Tabela 4.4 : Vlera e demit ekonomik sipas subjekteve dhe fushës ku është konstatuar, në '000 lekë

Subjektet	Procedura prokurimi	Shpenzime te tjera	Te Ardhura nga qiratë/ shitje/blerje/koncesione/PPP	Zbatim punimesh	Subjektet
AKSHI				18,442	18,442
Bashkia Kamëz	259			1,909	2,168
DPOP tiranë				232	232
Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.				791	791
Ujësjiellës-Kanalizime Tirane SHA	961	47,987	1,545	15,457	65,950
Total	1,220	47,987	1,545	36,831	87,583

Tabela 4.4 : Vlera e Menaxhimit jo efektiv te fondeve, sipas subjekteve dhe fushës ku është konstatuar, në ‘000 lekë

Subjekti	Procedura prokurimi	Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	Te Ardhura ne Urbanistike	Te Ardhura nga qiratë/ shitje/blerje/koncesione/PPP	Te Ardhura nga Tatim-taksat	Te Ardhura te tjera	Zbatim punimesh	Grand Total
AKSHI	5,205						156,311	161,516
Bashkia Belsh					108,398	7,400		115,798
Bashkia Kamëz	526,921				631,061			1,157,982
Bashkia Lezhë				817	402,198	7,200		410,215
Bashkia Vau Dejës		1,972	496	4,226	195,912	21,500		224,106
DPOP tiranë				102,116				102,116
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë							15,508	15,508
Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.	3,181						27,609	30,790
Ujësjiellës-Kanalizime Tirane SHA	1,742						3,672	5,414
Total	537,049	1,972	496	107,159	1,337,569	36,100	203,100	2,223,445

ANEKS 5: Masa disiplinore & administrative

Tabela 5: Masa disiplinore & administrative sipas kuadrit ligjor përkatës

Lloji i masës	Ligji nr. 142/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Grand Total
Kompetencë të Titullarit	14	14	28
Largim nga puna		6	6
Për punonjës te larguar nga puna	5	17	22
Vërejtje	7	8	15
Vërejtje me Paralajmërim		12	12
Total	26	57	83

Tabela 5.1: Masa disiplinore & administrative sipas llojit & subjektit

Lloji i masës	Ligji nr. 142/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Grand Total
Kompetencë të Titullarit	14	14	28
AKSHI		1	1
Bashkia Kamëz	13		13
Bashkia Vau i Dejës	1		1
DPOP Tirane		7	7
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë		1	1
Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.		4	4
Ujësjetllës-Kanalizime Tirane SHA		1	1
Largim nga puna		6	6
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug		6	6
Për punonjës te larguar nga puna	5	17	22
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug		17	17
Bashkia Kamëz	5		5
Vërejtje	7	8	15
Bashkia Belsh	7	1	8
Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.		7	7
Vërejtje me Paralajmërim		12	12
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug		12	12
Total	26	57	83